



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.2829/9 prot.

Datë 14.12.2023

**V E N D I M**  
**Nr. 1300/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.12.2023 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-83206-10-11-2023, me objekt: “Shërbimi i printimit dhe fotokopjimit për KESH Sh.A, zyrat qendrore dhe Njësitë e Prodhimit”, me fond limit 14,800,000.00 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 30.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë

**Ankimues:**

“Rikon-AL” SHPK me NIPT L22119010H dhe adresë: Njësia Administrative Kashar, Rruga Ismail Qemali, Nd.40, H.28,1050, Yzberisht, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:**

Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë me adresë: Rruga “Viktor Eftimiu”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë

**Subjekte të Interesuara:**

“Infosoft Office” SHPK me NIPT J62426002Q dhe adresë: Kashar, Autostarda Tiranë- Durrës, km8.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:****I***Vlerësimi paraprak*

I 1. Vlëra limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

I.4. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II**

## *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 12.10.2023, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-83206-10-11-2023, me objekt: “Shërbimi i printimit dhe fotokopjimit për KESH Sh.A, zyrat qendrore dhe Njësitë e Prodhimit”, me fond limit 14,800,000.00 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 30.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë.

II.2. Në datë 30.10.2023, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe informacionit të operatorit ekonomik ankimues rezulton, se në datën 06.11.2023, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

1) "Infosoft Office" sh.p.k,	7,692,000 lekë	kualifikuar
2) "RIKON-AL" sh.p.k,	7,920,000 lekë	kualifikuar
3) "BNT ELECTRONICS" sh.p.k,	8,040,000 lekë	kualifikuar
4) "SINTEZA CO" sh.p.k,	13,920,000 lekë	kualifikuar

II.5. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton se me 13.11.2023 është publikuar njoftimi i fituesit paraprak të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.6. Në datën 15.11.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3611 dhe me nr. 2829 prot., datë 15.11.2023, e operatorit ekonomik “Rikon-AL” SHPK., ku u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 2829/2 prot., datë 16.11.2023.

II.8. Me datë 20.11.2023, protokolluar me tonën me nr. 2829/3 prot., datë 21.11.2023 nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK ka paraqitur formularin e paraqitjes së argumenteve në cilësinë e operatorit ekonomik të interesuar në kuptim të nenit 113 të LPP-së.

II.9. Nëpërmjet shkresës me nr.5745/3 prot., datë 21.11.2023, protokolluar me tonën nr. 2829/4 prot., datë 21.11.2023, autoriteti kontraktor ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacionin dhe vendimin lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, nga ku rezulton, se KSHA e autoritetit kontraktor ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues duke argumentuar “[...]”

*Komisioni shqyrtimit të ankesave pasi u njoh me pretendimet e ankimuesit, verifikoi dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria “InfoSoft Office” sh.p.k.*

*1) Në lidhje me kriterin teknik pika 2.3.2 ku kërkohet se Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim / letër angazhimi / akt marrëveshje bashkëpunimi me prodhues ose distributor të autorizuar nga prodhuesi për software të menaxhimit të printimit dhe pajisjeve të ofruara.*

*Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.*

*Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në lidhje me këtë kriter “InfoSoft Office” sh.p.k, ka paraqitur nga PaperCut dokumentacionin: “Manufacture/Distributor Authorisation Form”, datë 27/10/2023. Në këtë dokument, shprehet: Me anë të këtij dokumenti, vërtetojmë se “InfoSoft Office” sh.p.k është një rishitës i autorizuar për programin software PaperCut. “InfoSoft Office” sh.p.k është i autorizuar të shesë, mirëmbajë dhe menaxhojë projektet e instalimit PaperCut, për kompani të vogla dhe të mëdha.*

*Dokumentacion i mësipërm është paraqitur i përkthyer dhe noterizuar me Nr. Rep 7713, datë 08/11/2023 “Vërtetim njësie me origjinalin” dhe Nr.Rep 7714 datë 08/11/2023 “Vërtetim përkthimi”.*

*Referuar pretendimit të ankimuesit se dokumentacioni i paraqitur për të plotësuar këtë pikë është në fakt një autorizim nga rishitës për territorin e Shqipërisë dhe jo nga Prodhuesi apo Distributori, sqarojmë se referuar pika 2.3.2, është kërkuar se Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim letër angazhimi fakt marrëveshje bashkëpunimi me prodhues ose distributor të autorizuar nga prodhuesi për software të menaxhimit të printimit dhe pajisjeve të ofruara.*

*Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.*

*2) Në lidhje me kriterin teknik, pika 2.3.3 ku kërkohet se Operatori Ekonomik duhet të ofrojë zgjidhje teknike e cila duhet të jetë në përputhje me Termat e Referencës. Për plotësimin e këtij kriteri Operatori Ekonomik duhet të paraqesë zgjidhjen teknike si do të realizojë zbatimin në përputhje me Termat e Referencës.*

*Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në lidhje me këtë kriter “InfoSoft Office” sh.p.k, ka paraqitur zgjidhjen teknike SLA. Referuar këtij dokumentacioni, operatori ekonomik ka plotësuar zgjidhjen sipas kërkesave teknike si: Orari i suportit, koha e përgjigjes, Koha e reagimit (në vend), Koha e riparimit, Menaxhimi i konsumit, Transporti dhe dërgesa dhe Niveli i shërbimit.*

*Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.”*

*Një lidhje me kriterin teknik, pika 2.3.4 ku kërkohet se Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar për periudhën Gusht 2023 minimalisht 6 (gjashtë ) punonjës nga të cilët:*

*- minimalisht 3 (tre) punonjës të certifikuar nga prodhuesi i pajisjeve ose institucione të autorizuar;*

*-minimalisht 1 (një) punonjës të certifikuar nga prodhuesi ose institucione të autorizuar për instalimin dhe konfigurimin e software të menaxhimit të printimit;*

*-minimalisht 1 (një) punonjës të certifikuar për planifikimin, analizimin dhe implementimin e shërbimeve të menaxhuara të printimit;*

*-minimalisht 1 (një) punonjës të certifikuar për sigurinë informatike të ndërhyrjes në sisteme;*

*Sqarim: Pranohej rastet kur një punonjës disponon më shumë se një certifikatë, por në mënyrë të kombinuar stafi duhet të plotësojë minimumin e certifikatave/dëshmime të kërkuara.*

*Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaratimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaratimit si: Kontratë pune të vlefshme; Certifikatat; Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Gusht 2023.*

*Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në lidhje me këtë kriter “InfoSoft Office” sh.p.k, ka paraqitur dokumentacionin për punonjësit:*

*1) K.C (B) - teknik i pajisjeve të fotokopjimit dhe printimit. Certifikuar si Teknik Servisi me 28/04/2017 nga Infolex S.A. Diplomuar si Inxhinier Matematike dhe Informatike,*

*2) D. P — teknik i pajisjeve të fotokopjimit dhe printimit. Certifikuar si Teknik Servisi me 14/01/2020 nga Infolex S.A. Diplomuar si Inxhinier Mekatronik,*

*3) A. H - teknik i pajisjeve të fotokopjimit dhe printimit. Certifikuar si Teknik Servisi me 26/11/2016 nga Infolex S.A, Diplomuar si Inxhinier Elektronike*

*4) 1 (një) punonjës të certifikuar nga prodhuesi ose institucione të autorizuar për instalimin dhe konfigurimin e software të menaxhimit të printimit — F. P — certifikuar me 13/01/7/20217 nga PaperCut dhe si Inxhinier Mekanik,*

*5) 1 (një) punonjës të certifikuar për planifikimin, analizimin dhe implementimin e shërbimeve të menaxhuara të printimit - F. B - teknik i pajisjeve te fotokopjimit dhe printimit. Certifikuar me 14/01/2020 nga Infolex S.A, Diplomuar si Inxhinier Mekatronik:*

*6) 1 (një) punonjës të certifikuar për sigurinë informatike të ndërhyrjes në sisteme - LP i certifikuar në “Bazat e Rrjeteve Kompjuterike” datë 24/02/2017 dhe “Arkitekturë PC” datë*

*13/12/2016 nga Qendra e Teknologjisë Tiranë dhe certifikuar me 11/06/2023 nga Cisco për ndërhyrjet në rrjet, Diplomuar me Master Profesional Teknologji Informacioni.*

*Për sa më sipër pretendimi i ankimesit nuk qëndron.*

*Sa më sipër mbështetur në nenin 114 të ligjit Nr.162 datë 23/12/2020 “Per Prokurimin Publik” dhe nenit 102 të VKM Nr.285, datë 19/5/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, I ndryshuar, Autoriteti Kontraktor KESH sh.a vendosi:*

*I-Mos pranimin e ankesës së operatorit ekonomik “RIKON-AL” sh.p.k, për procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbimi i printimit dhe fotokopjimit për KESH sh.a, zyrat qendrore dhe njësitë e prodhimit”, NR.REF-83206-10-11-2023.*

II.10. Me shkresën nr. 2829/5 prot., datë 01.12.2023, KPP iu drejtua autoriteti kontraktor me kërkesën si më poshtë: “[...]Aktualisht, me anë të shkresës Nr.5745/3 prot., datë 21.11.2023, protokolluar pranë institucionit tonë me Nr.2829/4 prot., datë 21.11.2023, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik ankimues për procedurën e mësipërme të prokurimit, sipas të cilit është vendosur mospranimi i ankesës.

*Me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 115 të LPP-së, autoriteti kontraktor, referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.” të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, dokumentacionin e plotë në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, të dorëzuar pranë autoritetit tuaj kontraktor, nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK së bashku me procesverbalin e dorëzimit të dokumentacionit, për sa i takon kriteret më sipër për të cilat ngrihen pretendime për mospërmushjen e tyre nga operatori ekonomik “Rikon-AL”.*

II.11. Me shkresën nr. 5914/1 prot., datë 04.12.2023 protokolluar me tonën me nr. 2829/6 prot., datë 06.12.2023 është depozituar në KPP informacioni ku ndër të tjera bashkëlidhur tij gjenden:

- Për punonjësen K. C (Balla) Certifikatë si Teknik Servisi e datës 28/04/2017 nga Infolex S.A,
- per punonjësin D.P - Certifikatë si Teknik Servisi e datës 14/01/2020 nga Infolex S.A,
- për punonjësin A.H - Certifikatë si Teknik Servisi e datës 26/11/2016 nga Infolex S.A,
- për punonjësin F.P certifikatë për vazhdimin e kompletimit të edukimit lëshuar nga Cisco CCNA me datë 2011.2018,
- për punonjësin F.B -Certifikatë si Teknik Servisi e datës 14/01/2020 nga Infolex S.A,
- për punonjësin L.P certifikatë në “Bazat e Rrjeteve Kompjuterike” datë 24/02/2017 dhe “Arkitekturë PC” datë 13/12/2016 nga Qendra e Teknologjisë Tiranë dhe certifikatë me 11/06/2023 nga Cisco për ndërhyrjet në rrjet.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

## Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Rikon” SHPK, për mospërbushjen nga operatori ekonomik “Infosoft Office” të kriterit 2.3.2: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim / letër angazhimi / akt marrëveshje bashkëpunimi me prodhues ose distributor të autorizuar nga prodhuesi për software të menaxhimit të printimit dhe pajisjeve të ofruara.*

*Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.2 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

**2.3.2** *Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/ letër angazhimi / akt marrëveshje bashkëpunimi me prodhues ose distributor të autorizuar nga prodhuesi për software të menaxhimit të printimit dhe pajisjeve të ofruara.*

*Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.*

III.1.4. Në përmbushje të kriterit më sipër operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar në SPE dokumentacionin si më poshtë:

- Autorizim prodhuesi/Distributori i kompanisë PaperCut European Authorised Solution Centre, Info Technology Supply Ltd i datës 27.10.2023 drejtuar KESH me përmbajtje si vijon “.....”, shoqëruar me vërtetim përkthimi me nr. REP 7395, datë 28.10.2023.

III.1.5. Në nenin 77, pikat 1 e ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.1.6. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 2, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

*“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

III.1.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.8. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/ letër angazhimi / akt marrëveshje bashkëpunimi me prodhues ose distributor të autorizuar nga prodhuesi për software të menaxhimit të printimit dhe pajisjeve të ofruara. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.”* Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori



ekonomik “Infosoft Office” SHPK për përmbushjen e kriterit të mësipërm i cili është edhe pretendim i ankimuesit “Rikon-AL” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në pikën III.1.4 të këtij vendimi. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Rikon-AL” SHPK për mospërmbushjen e kriterit më sipër nga operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, si dhe nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem nga ky i fundit, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK ka plotësuar kriterin e mësipërm lidhur me paraqitjen e autorizim/ letër angazhimi / akt marrëveshje bashkëpunimi me prodhues ose distributor të autorizuar nga prodhuesi për software të menaxhimit të printimit dhe pajisjeve të ofruara. Konkretisht, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK për përmbushjen e kriterit më sipër ka dorëzuar skedën Autorizim prodhuesi/Distributori i kompanisë PaperCut European Authorised Solution Centre, Info Technology Supply Ltd i datës 27.10.2023 drejtuar KESH me përmbajtje si vijon “.....” shoqëruar me vërtetim përkthimi me nr. REP 7395, datë 28.10.2023, i cili është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të përcaktuara si më sipër. Në analizë të fakteve dhe rrethanave më sipër, si dhe duke arsyetuar mbi përmbajtjen e tyre KPP gjykon, se dokumenti Autorizim prodhuesi/Distributori i kompanisë PaperCut European Authorised Solution Centre, Info Technology Supply Ltd i datës 27.10.2023 drejtuar KESH është i vlefshëm dhe plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.2. të kapacitetit teknik në dokumentet e tenderit. Sa më sipër, Komisioni gjykon, se operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK me dokumentacionin e dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, e përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit “kapaciteti teknik” të dokumenteve të tenderit. Bazuar në sa më lart, KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatorit ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me *lex specialis*.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “Rikon-AL” SHPK nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Rikon-AL” SHPK për mospërmbushjen nga operatorit ekonomik “Infosoft Office” të kriterit 2.3.3. ku përcaktohet se “2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë zgjidhje teknike e cila duhet të jetë në përputhje me Termat e Referencës.

*Për plotësimin e këtij kriteri Operatori Ekonomik duhet të paraqesë zgjidhjen teknike si do të realizojë zbatimin në përputhje me Termat e References.”* KPP vëren se,

III.2.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “Rikon-AL” SHPK, në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të

*ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Rikon-AL SHPPK për mospërbushjen e kriterit më sipër nga “Infosoft Office” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.*

III.2.2. Marrë shkas nga pretendimet e operatorit ekonomik “Rikon-AL” SHPK si dhe nga verifikimi i kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor për të cilin ankimuesi pretendon se nuk përmbushet nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK mbi bazën e të cilit është bërë më pas edhe shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertës, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se ky kriter është hartuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, pasi në vetvete nuk përbën një kriter kualifikues, për të vlerësuar kapacitetet ligjore, ekonomike dhe teknike të ofertuesve dhe konkretisht KPP vëren se:

III.2.3 Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.3 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

**2.3.3** *Operatori Ekonomik duhet të ofrojë zgjidhje teknike e cila duhet të jetë në përputhje me Termat e Referencës.*

*Për plotësimin e këtij kriteri Operatori Ekonomik duhet të paraqesë zgjidhjen teknike si do të realizojë zbatimin në përputhje me Termat e Referencës.*

III.2.4. Në përmbushje të kriterit më sipër operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar në SPE dokumentacionin si më poshtë:

-Deklaratë e datës 30.10.2023 e Operatorit ekonomik “Infosoft Office”SHPK drejtuar KESH

III.2.5. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Në neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të

*këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

Në nenin 77, pika 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

III.2.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.2.7. Sa më sipër, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kritereve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi. Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se ky kriter është hartuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, pasi në vetvete nuk përbën një kriter kualifikues, për të vlerësuar kapacitetet ligjore, ekonomike dhe teknike të ofertuesve, sepse vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike,

financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenin 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...] Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]”, gjykon se ky kriter është hartuar në kundërshtim me legjisllacionin në fuqi, pasi në vetvete nuk përbën një kriter kualifikues, për të vlerësuar kapacitetet ligjore, ekonomike dhe teknike të ofertuesve dhe hartimi i kriterit të kualifikimit, jo në përputhje me aktet ligjore/nënligjore në fuqi, përbën shkak për anulimin e kësaj procedure prokurimi. Në këtë kuptim autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit objekt-ankimi dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Rikon-AL” SHPK për mospërmbushjen nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK të kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.4 të dokumenteve të tenderit “**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar për periudhën Gusht 2023 minimalisht 6 (gjashtë ) punonjës nga të cilët:

- minimalisht 3 (tre) punonjës të certifikuar nga prodhuesi i pajisjeve ose institucione të autorizuar;
- minimalisht 1 (një) punonjës të certifikuar nga prodhuesi ose institucione të autorizuar për instalimin dhe konfigurimin e software të menaxhimit të printimit;
- minimalisht 1 (një) punonjës të certifikuar për planifikimin, analizimin dhe implementimin e shërbimeve të menaxhuara të printimit;
- minimalisht 1 (një) punonjës të certifikuar për sigurinë informatike të ndërhyrjes në sisteme;

**Sqarim:** Pranohen rastet kur një punonjës disponon më shumë se një certifikatë, por në mënyrë të kombinuar stafi duhet të plotësojë minimumin e certifikatave/dëshmime të kërkuara.

**Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetëdeklarimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:**

- ✚ *Kontratë pune të vlefshme;*
- ✚ *Certifikatat;*
- ✚ *Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Gusht 2023.” KPP vëren se,*

III.3.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “Rikon-AL” SHPK, në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përrjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Rikon-AL SHPPK për mospërmbushjen e kriterit më sipër nga “Infosoft Office” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.3.2. Marrë shkas nga pretendimet e operatorit ekonomik “Rikon-AL” SHPK, nga verifikimi i kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, në bazë të të cilave është bërë më pas edhe shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se kriteri më sipër është hartuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe shkakton konfuzion e paqartësi në mënyrën e përmbushjes së tij, si dhe në vlerësimin e ofertave, konkretisht KPP vëren se:

III.3.3. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.4 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

**2.3.4** *Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar për periudhën Gusht 2023 minimalisht 6 (gjashtë ) punonjës nga të cilët:*

- *minimalisht 3 (tre) punonjës të certifikuar nga prodhuesi i pajisjeve ose institucione të autorizuar;*
- minimalisht 1 (një) punonjës të certifikuar nga prodhuesi ose institucione të autorizuar për instalimin dhe konfigurimin e software të menaxhimit të printimit;*
- minimalisht 1 (një) punonjës të certifikuar për planifikimin, analizimin dhe implementimin e shërbimeve të menaxhuara të printimit;*
- minimalisht 1 (një) punonjës të certifikuar për sigurinë informatike të ndërhyrjes në sisteme;*

***Sqarim: Pranohen rastet kur një punonjës disponon më shumë se një certifikatë, por në mënyrë të kombinuar stafi duhet të plotësojë minimumin e certifikatave/dëshmime të kërkuara.***

***Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit***

**të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:**

-  Kontratë pune të vlefshme;
-  Certifikatat;
-  Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Gusht 2023.

III.3.4. Në përmbushje të kriterëve më sipër operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin si më poshtë:

- Formularin përmbledhës të vetëdeklaramit të operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK
- Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të ardhurat nga Punësimi” për periudhën gusht 2023.
- Për punonjësen K.Ci (B) - teknik i pajisjeve të fotokopjimit dhe printimit. Certifikatë si Teknik Servisi me 28/04/2017 nga Infolex S.A. Diplome si Inxhinier Matematike dhe Informatike, kontrate pune
- 2) Per punonjësin D. P - Certifikatë si Teknik Servisi me 14/01/2020 nga Infolex S.A. Diplomë si Inxhinier Mekatronik, kontratë pune
- 3) Për punonjësin A.H - Certifikatë si Teknik Servisi me 26/11/2016 nga Infolex S.A, Diplomë si Inxhinier Elektronik, kontratë pune
- 4) Për punonjësin F.P - Certifikatë e datës 13/01//2017 nga PaperCut dhe diplome Inxhinier Mekanik,
- 5) Për punonjësin F.B - Certifikatë me datë 14/01/2020 nga Infolex S.A, Diplomë si Inxhinier Mekatronik:
- 6) Per punonjesin L.P certifikate në “Bazat e Rrjeteve Kompjuterike” datë 24/02/2017 dhe “Arkitekturë PC” datë 13/12/2016 nga Qendra e Teknologjisë Tiranë dhe certifikatë me 11/06/2023 nga Cisco për ndërhyrjet në rrjet, Diplomuar me Master Profesional Teknologji Informacioni, kontratë pune.

III.3.5. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efijcencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për

*operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

Në nenin 77, pika 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshatshmerinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

III.3.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.3.7. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e

nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike, është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Referuar kriterit për kualifikim më sipër Komisioni gjykon, se hartimi i kërkesave brenda kriterit është kontradiktor dhe krijon konfuzion si tek operatorët ekonomikë në përgatitjen e ofertave të tyre, ashtu edhe te Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në momentin e vlerësimit të procedurës së prokurimit, pasi autoriteti kontraktor për pikën 1 dhe 2 të këtij kriteri nuk ka përcaktuar *institucionin e autorizuar*, i cili duhet të lëshojë certifikatën në mënyrë që operatorët ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit të ofertojnë mbi bazën e kriterëve të sakta dhe të qarta, si dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të mund të shprehet mbi përmbushjen e këtyre kriterëve të përcaktuara qartësisht si kusht për kualifikimin e operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit. Po ashtu për kërkesën e tretë dhe të katërt të përcaktuar brenda kriterit më sipër, autoriteti kontraktor nuk ka përcaktuar personin juridik juridik privat ose institucionin/organin publik apo privat i cili duhet të certifikojë punonjësit për planifikimin, analizimin dhe implementimin e shërbimeve të menaxhuara të printimit dhe për sigurinë informatike të ndërhyrjes në sisteme, duke shkaktuar konfuzion si në përgatitjen e ofertave ashtu edhe në mënyrën e vlerësimit të tyre. KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe Gjykata Europiane e Drejtësisë (GJED) ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor ka hartuar një kriter të paqartë i cili shkakton konfuzion në përgatitjen e ofertave dhe në mënyrën e vlerësimit të tyre, duke rënë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik. Kështu që, në lidhje me pretendimin e mësipërm të ankimesit nuk mund të garantohet një mjet ankimi efektiv, pasi KPP nuk mund të shprehet mbi themelin e kërkesave, duke qenë se kriteri i hartuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, pasi është një kriter i paqartë i cili shkakton konfuzion në përgatitjen e ofertave si dhe në vlerësimin e tyre. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se kriteret e kualifikimit si dhe specifikimet teknike duhet të përcaktohen të qarta dhe të sakta nga autoriteti kontraktor si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, volumin dhe objektin e kontratës objekt-prokurimi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi të operatorëve ekonomikë të interesuar, si dhe duke mos i dëmtuar pjesëmarrësit në këtë procedurë.

III.3.8. Bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenin 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në



*këtë ligj*”, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]” Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik të dokumentave të tenderit “2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar për periudhën Gusht 2023 minimalisht 6 (gjashtë ) punonjës nga të cilët:

- minimalisht 3 (tre) punonjës të certifikuar nga prodhuesi i pajisjeve ose institucione të autorizuar;

-minimalisht 1 (një) punonjës të certifikuar nga prodhuesi ose institucione të autorizuar për instalimin dhe konfigurimin e software të menaxhimit të printimit;

-minimalisht 1 (një) punonjës të certifikuar për planifikimin, analizimin dhe implementimin e shërbimeve të menaxhuara të printimit;

-minimalisht 1 (një) punonjës të certifikuar për sigurinë informatike të ndërhyrjes në sisteme;

*Sqarim: Pranoen rastet kur një punonjës disponon më shumë se një certifikatë, por në mënyrë të kombinuar stafi duhet të plotësojë minimumin e certifikatave/dëshmime të kërkuara.....”, nuk është në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, pasi shkakton paqartësi si te operatorët ekonomikë ofertues, ashtu edhe të komisioni i vlerësimit të ofertave, dhe në kushtet kur autoriteti kontraktor ka vlerësuar mbi kritere jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi.*

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos:**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Rikon-AL” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-83206-10-11-2023, me objekt: “Shërbimi i printimit dhe fotokopjimit për KESH sh.a, zyrat qendrore dhe Njësitë e Prodhimit”, me fond limit

14,800,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 30.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë .

2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
  3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
  4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Rikon-AL” SHPK.
  5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

<b>Nënkryetar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Fiorent Zguro</b>	<b>Kreshnik Ternova</b>	<b>Anila Malaj</b>

**Kryetar**

**Jonaid Myzyri**

